



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:068885
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05479974

CN.nr.223/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit A. B. me adresë rr. A. J. nr...., Pej2, kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës-Departamenti i Automjeteve-Divizioni i Autoshtokollave me seli në ish ndërtesa e Gërmisë “Nëna Terezë” Prishtinë, lidhur me çështjen juridike, Anulim vendimi, njohje e përgjegjës së saktë, vazhdim licensimi për 3 vite, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës të hapur nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në çështjen juridike të paditësit A. B. me adresë rr. A. J. nr...., Pej2, kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës-Departamenti i Automjeteve-Divizioni i Autoshtokollave me seli në ish ndërtesa e Gërmisë “Nëna Terezë” Prishtinë, lidhur me çështjen juridike, Anulim vendimi, njohje e përgjegjës së saktë, vazhdim licensimi për 3 vite, është kompetente lëndore Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Administrative, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin A.nr.856/2021 të datës 14.07.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për vendosje sipas padisë së paditësit duke e dërguar lëndën në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, për gjykim sipas padisë së paditëses.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil nuk e ka pranuar kompetencën lëndore dhe me aktvendimin C.nr.4921/2023 e datës 25.10.2023, e ka hapur konfliktin e kompetencës duke kërkuar që lënda ti dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative si gjykatë me kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të dy Gjykatave Themelore, gjeti së kompetente lëndore dhe territoriale për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese është Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Administrative pasi që:

Gjykata e Apelit duke vendosur në lidhje me konfliktin e kompetencës të shkaktuar në mes të dy Departamenteve të së njëjtës gjykatë, gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative nuk ka mundur të shpallet jo kompetente për të gjykuar çështjen pasi që kompetente në pikëpamje lëndore dhe territoriale është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative. Kjo për faktin se paditësi me padi kërkon të anulohet vendimi i të paditurës nr.ref.01/2433 i datës 19.09.2021 si dhe detyrimi i të paditurës që të konsideroj përgjigjen e saktë në pyetjen e tret (3) të testit për pyetës teorik dhe të konsiderohet se ka kaluar testin me suksese. Andaj, çështja e ngritur me padi është çështje e ngritur ndaj vendimit përfundimtar të të paditurës në lidhje me mos ri licencimin e paditësit dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kontest pune, kjo për faktin se paditësi nuk ka aplikuar pran të paditurës për punësim siç ka pretenduar Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ kur është shpallur jo kompetent, por paditësi pranë të paditurës i është nënshtruar testit me shkrim për ri licencim si pyetës teorik dhe jo për punësim, pasi që, pas ri licencimit atëherë paditësit do ti lindë e drejta që të aplikoj për punësim dhe Departamenti Administrativ nuk ka mundur të thirret në dispozitat e ligjit të punës sepse vendimi të cilin paditësi e ka atakuar me padi është nxjerrë në kuptim të ligjit të procedurës së Përgjithshme Administrative dhe ka të bëjë me refuzimin e ankesës së paditësit kundër njoftimit për mos kalimit të testit me shkrim për ri licencim dhe të gjitha procedura e zhvilluara për licencim janë zhvilluar në kuadër të ligjit të Përgjithshëm Administrativë. Andaj, pretendimi i Departamentit për çështje Administrative se pozita e punës e pyetësit teorik është pozitive që rregullohet me ligj të punës nuk është e drejtë pasi që kjo çështje ka të bëjë me procedurën e licencimit dhe jo për krijim të vendit të punës, pasi që paditësi nuk i ka përmbushur kushtet formale për tu konsideruar pyetës teorik pasi që sipas nenit 3 par.1 i U.A 08/16 për pyetës, ku parashihet se *“Pjesën teorike dhe praktike të provimit për patent shofer e mban personi i licencuar për pyetës nga Ministria, i autorizuar me vendim të ministrit, ndërsa në par.2 të këtij neni është përcaktuar se personi nga par.1 nuk është shërbyes civil. Në rastin konkret të drejtën për tu punësuar e kanë vetëm personat e licencuar, gjë që paditësi nuk ka qenë në këtë fazë.*

Mbi bazë të kësaj Gjykata e Apelit vlerëson se Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk është dashur të shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për zgjidhjen e kontestit të ngritur me padi nga paditësi, pasi që paditësi në testin çfarë ju ka nënshtruar ka të bëjë me ri licencim dhe në këtë kuptim gjykata Administrative nuk mund ta vlerësoj paditësit si i punësuar. Andaj, sipas nenit 23 paragrafi 1 i Ligjit për Konfliktin Administrativ është përcaktuar se: *“Për paditë kundër akteve administrative të të gjitha organeve vendos gjykata kompetente për çështjet administrative në shkallë të parë, nëse me dispozita të tjera ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.”* e që në rastin e kësaj lënde, kemi të bëjmë me kërkesë për anulimin e vendimit të nxjerrë nga organi administrativ respektivisht vendim të ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës me të cilin vendim këtu paditësit i është

refuzuar ankesa dhe në këshillë juridike është udhëzuar se pala e pakënaqur mund të hapë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative, në afat prej 30 dite nga dita e pranimiit.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit objekti i kërkesëpadisë nuk bënë pjesë në kompetencë të divizionit civil për faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kontratë të rregullt të punës por kemi të bëjmë me pretendime se është shkelur procedura pranë organit administrativ për ri licencim e cila procedurë është zhvilluar sipas, sipas të cilave procedura licencohet pyetësit dhe pastaj të mund të caktohet me vendim në punë dhe detyra specifike mes ministrisë dhe personit të përzgjedhur.

Në kuptim të arsyeve të sipër theksuar Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Administrative është kompetente lëndore për gjykimin sipas padisë së paditësit dhe jo Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.

Nga të lartë cekurat e në pajtim me dispozitën e nenit 25 paragrafi 1 i LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CN.nr. 223/2023, me datë 12.03.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v